

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7992
E premte, 14 shkurt 2025
Çmimi 0.50

Pozita e presidentit mund të bëhet pjesë e "pazareve" për qeverinë e re | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA KËRKUAR
RUAJTJEN E INTEGRITETIT TË PROCESIT ZGJEDHOR | FAQE 4-5

KQZ-ja: PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE MUND TË ZGJASË DERI NË DY JAVË



Vonesat në fillimin e numërimit të votave të kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe problemet e njëpasnjëshme me faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë ngritur dyshime për integritetin

e procesit zgjedhor. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, gjatë një takimi me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka kërkuar ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor. Ky i fundit

në mbledhjen e KQZ-së ka parashikuar se procesi i numërimit të të gjitha votave për kandidatë për deputetë do të mund të zgjasë deri në dy javë, ndonëse nuk është bërë ndonjë vlerësim i saktë

KOSOVA NË BISHT TË SORRËS TË INTERESIMIT NDËRKOMBËTAR | F.7

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



KALLASI: DO TË PËRPIQEMI TA BËJMË FUNKSIONAL DIALOGUN KOSOVË - SERBI | F.3



AKTUALE



VITI 2024, SIPAS CPJ-së, ISHTE MË VDEKJEPRURËSI PËR GAZETARËT | F.2

BDI-ja NIS REFORMËN GJITHËPËRFSHIRËSE TË PARTISË DHE PROCESIN E VETINGUT | F.3

ISH-AMBASADORI PEÇI: KOSOVA KA HYRË NË PERIUHDHËN MË TË PAPARASHIKUESHME POLITIKE | F.7

EKONOMI



"PASTRIMI" ME AKUZA PËR KOMUNËN E PRISHTINËS: KENI VENDOSUR QË MENAXHIMI I MBETURINAVE T'I JEPET NJË KOMPANIE PRIVATE DHE TË ELIMINOHET 'PASTRIMI' | F.8

ZKA-ja AUDITON MENAXHIMIN E FONDEVE PËR BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË | F.8

SPORT



LABINOT HAZIRI EMËROHET TRAJNER I 2 KORRIKUT | F.8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Viti 2024, sipas CPJ-së, ishte më vdekjeprurësi për gazetarët

NJU-JORK, 13 SHKURT - Në vitin 2024 janë vranë më shumë gazetarë se në çdo vit tjetër, tha Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve (CPJ) në një raport. CPJ, i cili filloi të mbledhë të dhëna para rreth 30 vjetëve, tha se të paktën 124 gazetarë dhe punonjës të medias u vranë në vitin 2024.

Në raport thuhet se në vrasjen e gazetarëve ka ndikuar rritja e numrit të konflikteve në mbarë botën - qofshin ato politike, kriminale apo ushtarake.

Lufta në Rripin e Gazës ka ndikuar më së shumti në

rritjen e numrit, pasi një numër i paparë gazetarësh dhe punonjësish të medias u vranë në këtë luftë, tha CPJ, e cila është organizatë joqeveritare me qendër në ShBA e përkushtuar për mbrojtjen e lirive të gazetarëve dhe të drejtave.

Pothuajse dy të tretat e numrit të përgjithshëm të punonjësve të medias të vranë në mbarë botën janë palestinezë, sipas raportit. Vitin e kaluar u vranë 85 gazetarë, ndërsa në vitin 2023 u vranë 73.

“Tani është koha më e rrezikshme për të qenë gazetar



në historinë e CPJ-së”, tha drejtoresha ekzekutive e CPJ-së, Jodie Ginsberg. “Lufta në Gaza është e paprecedentë në ndikimin e saj te gazetarët dhe demonstroi një përqendrim të ndjeshëm të normave globale për mbrojtjen e gazetarëve në zonat e konfliktit, por është larg nga i vetmi vend ku gazetarët janë në rrezik. Shifrat tona tregojnë se gazetarët janë nën sulm në mbarë botën”, shtoi ajo.

CPJ tha se zbuloi se të paktën 24 gazetarë në mbarë botën u vranë qëllimisht për punën e tyre vitin e kaluar.

Vetura godet turmën e njerëzve në Muni, dhjetëra të lënduar

MUNIH, 13 SHKURT - Një person e ka përplasur një veturë në një turmë njerëzish, të cilët ishin mbledhur për të protestuar, në Muni, të enjten, duke lënduar të paktën 28 persona, përfshirë fëmijë, njoftuan autoritetet gjermane. Sipas autoriteteve, incidenti besohet të ketë qenë sulm, ndërsa i dyshuari - një azilkërkues afgan - është arrestuar.

Pjesëmarrësit në demonstratën e sindikatës së punëtorëve ‘ver.di’ po ecnin nëpër një rrugë afër qendrës së Muniut, rreth orës 10:30 të mëngjesit, kur vetura kaloi një automjet policor që po e përcillte tubimin, rriti shpejtësinë dhe u përplas me



njerëzit, raporton “Associated Press”.

Oficerët arrestuan të dyshuarin

pasi shtënë me armë ndaj automjetit, bëri me dije zëvendëshefi i policisë,

Christian Huber. Ai shtoi se të paktën 28 persona besohet të jenë lënduar, disa prej të cilëve rëndë.

Një automjet i dëmtuar, i markës Mini, u pa në vendin e ngjarjes, bashkë me mbetje të tjera, përfshirë këpucë.

I dyshuari është një azilkërkues afgan, 24-vjeçar, tha Huber. “Dyshohet të jetë sulm - shumë gjëra sinjalizojnë këtë”, tha guvernatori i Bavarisë, Markus Soeder, në vendin e ngjarjes.

Incidenti pason një varg sulmesh ku janë përfshirë imigrantët gjatë muajve të fundit, të cilët e kanë vënë imigracionin në ballë të fushatës për zgjedhjet e 23 shkurtit në Gjermani.

Më së fundi, një djalë dyvjeçar dhe një person tjetër u vranë nga një sulm me thikë në Ashafenburg, po ashtu në Bavari.

Siguria do të rritet dukshëm në kryeqendrën bavareze gjatë ditëve të ardhshme për shkak se Konferenca treditore e Sigurisë në Muni, një tubim i përvitshëm i zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë të politikës së jashtme dhe sigurisë, hapet zyrtarisht të premtën.

Ministri i Brendshëm i Bavarisë, Joachim Herrmann, ka thënë se autoritetet nuk besojnë se incidenti i së enjtes është i lidhur me konferencën, por se ato ende po punojnë për ta përcaktuar motivin.

Aleatët e NATO-s ngulin këmbë se Ukraina dhe Evropa duhet të përfshihen në bisedime me Rusinë

Bruksel, 13 shkurt - Disa vende aleate të NATO-s kanë theksuar të enjten se Ukraina dhe Evropa nuk duhet të përjashtohen nga bisedimet për paqe, pasi administrata e presidentit amerikan Donald Trump sinjalizoi se synon fillimin e bisedimeve ballë për ballë me Rusinë, pa përfshirë ato. “Të mos harrojmë, Rusia mbetet kërcënim edhe [për vendet] shumë përtej Ukrainës”, tha sekretari i Mbrojtjes i Britanisë së Madhe, John Healey, pasi ShBA-ja tronditi NATO-n duke thënë se Ukraina nuk duhet t’i bashkohet aleancës ushtarake dhe se aleatët evropianë duhet ta marrin përsipër ofrimin e garancive të sigurisë për Ukrainën në të ardhmen. “Nuk mund të ketë bisedime për Ukrainën pa Ukrainën. Zëri i Ukrainës duhet të dëgjohet në

çfarëdo bisedimesh”, tha Healey për gazetarë në selinë e NATO-s.

Ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Boris Pistorius, tha: “Për mua është e qartë... Evropa duhet të përfshihet në bisedime dhe mendoj se kjo mund të kuptohet lehtësisht”. Ministrat e 32 vendeve anëtare të NATO-s janë mbledhur për bisedime për Ukrainën në Muni.

Ministri i Mbrojtjes i Suedisë, Pal Jonson, tha se vendet evropiane siguruan rreth 60% të mbështetjes ushtarake për Ukrainën vitin e kaluar dhe duhet të jenë të përfshira, veçanërisht duke pasur parasysh kërkesat e SHBA-së që Evropa të marrë më shumë përgjegjësi për sigurinë e Ukrainës në të ardhmen. “Është shumë e natyrshme që ne të



angazhohemi në këto diskutime”, tha Jonson. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se pavarësisht se çfarë marrëveshje arrihet mes Rusisë dhe Ukrainës, është jetike që “marrëveshja e paqes të jetë e qëndrueshme, që Putini ta kuptojë që ky është fundi, që ai të mos tentojë kurrë më ta kapë

asnjë pjesë të Ukrainës”. Ministri estonez i Mbrojtjes, Hanno Pevkur, theksoi se bashkimi evropian ka udhëhequr vendosjen e sanksioneve kundër Rusisë, ka investuar shumë në mbrojtjen e Ukrainës dhe do t’i kërkojë të mbulojë faturën për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. “Ne

duhet të jemi aty. Pra, nuk ka asnjë dyshim për këtë. Përndryshe, kjo paqe nuk do të zgjasë”, paralajmëroi Pevkur. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, u tha mbështetësve perëndimorë të Ukrainës të mërkurën se anëtarësimi i Ukrainës në NATO nuk është i mundur. Ai gjithashtu tha se Kievi duhet të heqë dorë nga shpresat për ta rimarrë të gjithë territorin e tij nga Rusia dhe në vend të kësaj të përgatitet për një marrëveshje të negociuar për paqe, e cila do të mbështetet nga trupa ndërkombëtare. Pasi bisedoi me Putinin dhe më pas me Zelenskyn, Trumpi tha të mërkurën se ai “ndoshta” do të takohet personalisht së shpejti me liderin rus dhe sugjeroi se takimi mund të ndodhë në Arabinë Saudite.

Kallasi: Do të përpiqemi ta bëjmë funksional dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 13 SHKURT - Shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian (BE), Kaja Kallas, ka thënë të enjten se është duke dëgjuar kritika rreth formatit të deritashëm të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo paralajmëroi se do ta shqyrtojë mundësinë, së bashku me të dërguarin e ri për dialogun, Peter Sorensen, për ta bërë funksional dialogun mes dy vendeve fqinje. "Sapo kemi emëruar një përfaqësues të posaçëm për dialog mes Beogradit dhe Prishtinës. Dhe unë do të ulem me të në mars, për të parë se si do të vazhdojmë me këtë", tha Kallasi në një bisedë të përbashkët me grupin "Redaksia Evropiane", ku bëjnë pjesë rreth 20 agjenci evropiane të lajmeve. "Unë vërtet dua të shikoj se si mund ta bëjmë këtë funksional. E kam adresuar këtë edhe me ministrin e Jashtëm të Serbisë. Dhe ai më ka thënë se është i gatshëm vërtet të investojnë kohë në normalizimin", tha Kallasi.

Kosova dhe Serbia dialogojnë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian që nga viti 2011. Në vitet e fundit dialogu

është zhvilluar në nivel të lartë, mes liderëve të dy vendeve, dhe në nivel kryenegociatorësh. Gjatë mandatit gati pesëvjeçar të të dërguarit të kaluar të bllokut, Miroslav Lajçakut, në fillim të vitit 2023 Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen për në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjërish e detyrueshme për palët, ka thënë blloku, i cili i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnisen e zbatimit të paktit.

Në të kaluarën, liderë të Kosovës, nisur nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani e deri te kryeministri Albin Kurti, e kanë kritikuar Lajçakun për qasje të pabalancuar në dialog dhe për rreshtim me raste kah Serbia.

Pasardhësi i tij, Peter Sorensen nga Danimarka, e nisi zyrtarisht punën më 1 shkurt. Nuk është e qartë se kur mund ta mbajë takimin e parë Sorenseni në kuadër të dialogut, duke qenë se Kosova mbajti zgjedhje më 9 shkurt dhe pritet ta formojë qeverinë e re, ndërsa Serbia përball



me paqartësi politike pas dorëheqjes së kryeministrit. Kallasi tha se po pret derisa Kosova të formojë qeveri të re, për të "parë se si të vazhdojmë tutje".

Sorenseni, për dallim nga paraardhësi i tij, do të merret vetëm me dialogun ndërmjet dy vendeve fqinje, e jo edhe me çështje rajonale të Ballkanit.

Emërimi i Sorensenit është parë si pozitiv, duke qenë se 57-vjeçari e njeh rajonin. Diplomati prej shumë vitesh,

ai ishte angazhuar në Kosovë, në kuadër të Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si dhe në role të tjera, në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë. Sipas njohësve të politikës, ai nuk ka nevojë të informohet paraprakisht për njerëzit apo faktet historike të rajonit, sepse tashmë ka pasur mundësinë ta krijojë një pasqyrë nga afër.

Një tjetër argument që është përmendur si pozitiv nga

zyrtarët në Prishtinë është se ai është nga Danimarka, vend që njeh shtetësinë e Kosovës, dhe se do të ketë qasje të barabartë në dialog. Kallasi përsëriti të enjten se normalizimi i marrëdhënieve fqinjësore është i nevojshëm për Kosovën dhe Serbinë për të ecur përpara. "Nëse ato mendojnë se mund të lëvizin në rrugëtimin evropian pa normalizimin e marrëdhënieve, atëherë unë mendoj se një gjë e tillë nuk është e mundur", tha ajo.

BDI-ja nis reformën gjithëpërfshirëse të partisë dhe procesin e vetingut

SHKUP, 13 SHKURT - Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) ka njoftuar për fillimin e një procesi të gjithanshëm reformash dhe vetingu brenda partisë, të udhëhequr nga kryetari i partisë, Ali Ahmeti dhe kryesia e partisë.

Në njoftimin për medie, theksohet se kjo nismë nënvizon përkushtimin e BDI-së për qeverisje dhe integritet shembullor, duke vendosur një standard të ri për partitë politike në rajon. "Si pjesë e strategjisë së reformës, BDI po zbaton mekanizma konkretë që synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies brenda radhëve të saj. Deputetët e BDI-së i janë nënshtruar një vlerësimi të rrezikut të



korrupsionit dhe kanë nënshkruar Kodin e Praktikës së Mirë dhe Integritetit të BDI-së. Ky kod përputhet me Kodin e Praktikës së Mirë në Fushën e Partive Politike, të miratuar nga Rezoluta e

Komisionit të Venecias dhe e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE)", ka njoftuar BDI. Më tej në njoftim thuhet se BDI-ja është e vendosur ta zgjerojë këtë proces të

vetingut përtej nivelit parlamentar, duke synuar të gjithë zyrtarët e nivelit të lartë të partisë, anëtarët e Kryesisë së BDI-së dhe kryesinë lokale të degës së partisë. "Ky plan strategjik veprimi synon jo vetëm ta përforcojë qëndrimin e partisë kundër korrupsionit, por edhe të nxisë një kulturë integriteti brenda proceseve politike. Duke udhëhequr me këto reforma, BDI krijon një precedent për t'i ndjekur partitë e tjera politike. Kjo nismë ripohon përkushtimin e BDI-së për sundimin e ligjit dhe tregon përkushtimin e partisë për ta trajtuar korrupsionin në rrënjët e tij", thuhet ndër tjera në njoftim. Theksohet se kryetari Ali Ahmeti ka thënë se BDI-ja

është e përkushtuar në ndërtimin e integritetit të jashtëzakonshëm institucional dhe personal. "Qasja jonë është gjithëpërfshirëse dhe e mirëplanifikuar, duke u fokusuar tek individët me integritet të fortë, të cilët do ta mbrojnë agjendën kundër korrupsionit dhe procesin e vetingut", ka thënë Ali Ahmeti. Thuhet se nëpërmjet veprimeve strategjike dhe angazhimit të palëkundur, BDI mbetet e përkushtuar për vendosmërinë e saj për të udhëhequr me shembull me qëllimin përfundimtar për të realizuar ndryshime domethënëse brenda partisë dhe, në fund të fundit, në kuadrin kombëtar të qeverisjes.

Osmani merr pjesë në Konferencën e Sigurisë në Muni

PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Gjermani për të marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë në Muni (MSC), një nga forumet më prestigjioze globale për çështjet e sigurisë dhe politikës së jashtme. Gjatë qëndrimit në Muni, presidentja Osmani do të

zhvillojë takime me liderë botërorë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe personalitete të rëndësishme të politikës globale, me fokus forcimin e partneritetit strategjik dhe avancimin e interesave të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Përveç takimeve bilaterale, Osmani do të marrë pjesë

edhe në panele diskutimi që organizohen përgjatë konferencës. Konferenca e Sigurisë në Muni, e themeluar në vitin 1963, është një platformë e pavarur që synon promovimin e zgjidhjeve paqësore të konflikteve, dialogut ndërkombëtar dhe bashkëpunimit në mes shteteve.





PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA KËRKUAR RUAJTJEN E INTEGRITETIT TË PROCESIT ZGJEDHOR

KQZ-ja: Procesi i numërimit të votave mund të zgjasë deri në dy javë

Vonesat në fillimin e numërimit të votave të kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe problemet e njëpasnjëshme me faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë ngritur dyshime për integritetin e procesit zgjedhor. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, gjatë një takimi me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka kërkuar ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor. Ky i fundit në mbledhjen e KQZ-së ka parashikuar se procesi i numërimit të të gjitha votave për kandidatë për deputetë do të mund të zgjasë deri në dy javë, ndonëse nuk është bërë ndonjë vlerësim i saktë

të qytetarëve duke rikonfirmuar çdo votë edhe nëpërmjet numërimit manual, përveç atij të bërë në sistemin elektronik.

Në takim Osmani shtroi nevojën e koordinimit të mekanizmave institucionale për ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe të vet votës së qytetarëve.

Në orën 08:00 të ditës së enjte ka vazhduar procesi i numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit në komunat: Deçan, Gjakovë, Drenas, Gjilan, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Obiliq, Prishtinë, Skenderaj, Shtërpçë, Viti, Ranillug, Partesh, Kllokot, Mitrovicë e Veriut dhe Hani i Elezit.

Gjithashtu, procesin e numërimit e ka filluar edhe Qendra Komunale e Numërimit në Ferizaj, ndërsa për qendrat e tjera të cilat do ta fillojnë procesin e numërimit do të njoftojmë së shpejti.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ditën e mërkurë ka filluar procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike në 14 komuna të tjera. Në ndërkohë zyrtarët e saj kanë siguruar se rezultatet e zgjedhjeve do të jenë të sakta pavarësisht prej vonesave dhe dyshimeve.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka parashikuar të enjten se procesi i numërimit të të gjitha votave për kandidatë për deputetë do të mund të zgjasë deri në dy javë, ndonëse nuk është bërë ndonjë vlerësim i saktë. "Megenëse nuk kemi filluar në të gjitha Qendrat Komunale të Numërimit për të parë se si po shkon atje procesi, nuk e kemi bërë një vlerësim se sa do të zgjatet tërë procesi për

t'u përmbyllur numërimi, por një e përafërt do të jetë 10 ditë, dy javë", ka thënë ai.

Në mbledhjen e KQZ-së është bërë me dije se tashmë ka nisur procesi i numërimit të votave për kandidatët për deputetë në 18 komuna, në tetë komuna numërimi pritet të nisë sot, ndërsa në 12 të tjera po bëhen përgatitje.

Kosova i ka mbajtur zgjedhjet e rregulla parlamentare më 9 shkurt.

Me Ligjin e ri për Zgjedhjet në Kosovë, të miratuar më 2023, votat për kandidatët për deputetë do të duhej të nisnin të numëroheshin në mëngjesin e 10 shkurtit, mirëpo zyrtarët e KQZ-së kanë përmendur problemet administrative si arsye për vonesat.

Drejtori i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, Besnik Buzhala, ka thënë se shkaktarë për vonesat në numërim janë problemet në ofrim të shërbimeve të teknologjisë informative, siç është lidhja e kamerave me laptopë dhe monitorë. Ai ka thënë se KQZ-ja është duke angazhuar profesionistë të teknologjisë informative nëpër këto komuna për ta përmbyllur aspektin e funksionalizimit.

Zyrtarët të KQZ-së i kanë bërë thirrje Buzhalës që të ketë gati një Plan B në rast se sistemi do të vazhdojë të dështojë, apo të ketë probleme të tjera me qasjen në të. Ai ka garantuar që nëse në ditët në vijim problemet do të vazhdojnë të raportohen, atëherë KQZ-ja do t'i kthehet metodës së vjetër dhe do të hapë tender për t'i siguruar tre lloje formularësh, për të përmblytur këtë proces sa më shpejt që është e mundur. Megjithatë, zyrtarët të KQZ-së janë pajtuar njëzëri që të mos luftohet për shpejtësi,

por për saktësi të rezultateve.

KQZ-ja është përballur me probleme me serverë edhe në ditën e zgjedhjeve, kur janë numëruar vetëm votat për subjekte politike. Disa kanë aluduar që faqja mund të ketë qenë shënjestër e ndonjë sulmi kibernetik.

Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se nuk ka informacione shtesë, pasi tani rasti u takon Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit.

Organizatrat joqeveritare kanë fajësuar KQZ-në për problemet që kanë dalë prej nisjes së numërimit të votave.

Partitë në pushtet e kanë fajësuar qeverinë, ndonëse ajo është kundërpërgjegjgur, duke thënë se nuk është përgjegjëse për serverët e KQZ-së, dhe se softueri i është dhuruar KQZ-së nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ndërsa akuzat drejt ekzekutivit i ka konsideruar përpjekje të ulët "për të shkaktuar huti, me qëllim që të ulët besimin në procesin zgjedhor dhe në rezultatin e tij".

Pas 99 për qind të votave të numëruara, Lëvizja Vetëvendosje prin me mbi 40 për qind të votave, Partia Demokratike e Kosovës është e dyta me rreth 22 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës e treta me 17 për qind të votave, pasuar nga koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate me rreth 7 për qind të votave.

Asnjëra parti nuk i ka siguruar votat e nevojshme për ta formuar qeverinë - pasi nevojiten votat e 61 deputetëve, prandaj njohësit e çështjeve politike kanë paralajmëruar se Kosova mund të përballet me turbulencia politike në ditët dhe javët në vijim.

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar të enjten me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi. Tema kryesore e këtij takimi ishte mbarëvajtja e procesit zgjedhor, me ç'rast presidentja ripotencoi rëndësinë e angazhimit të plotë për garantimin dhe ruajtjen e integritetit të këtij procesi. Lidhur me problemet e evidentuara në platformën elektronike të raportimit të rezultateve, Radoniqi sqaroi se KQZ-ja menjëherë ka ftuar institucionet e sigurisë dhe ato të drejtësisë që ta hetojnë problemin dhe se KQZ-ja është në pritje të raportit përfundimtar nga institucionet e sigurisë mbi çështjet e identifikuar që kanë ndikuar në funksionimin e kësaj platforme. Ky raport do të ndihmojë në

vlerësimin dhe adresimin e çështjeve të evidentuara, duke siguruar transparencë të plotë mbi arsyet që kanë çuar te ky problem.

Njëkohësisht, presidentja Osmani është njoftuar nga Radoniqi se KQZ-ja është duke punuar për të garantuar që çdo votë të dhënë për partitë politike të konfirmohet edhe gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatëve. Sipas kreut të KQZ-së, ky proces po realizohet me kujdes të shtuar për ta siguruar përputhjen e plotë ndërmjet votave të regjistruara në sistem dhe atyre që ndodhen në kutitë e votimit.

Që nga dita e zgjedhjeve presidentja ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me kryetarin Radoniqi si dhe institucionet përkatëse të sigurisë dhe ka kërkuar që të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ta mbrojtur procesin zgjedhor dhe për ta garantuar respektimin e plotë të vullnetit

Pozita e presidentit mund të bëhet pjesë e “pazareve” për qeverinë e re

Njohësit e çështjeve politike thonë se koalicionet eventuale pas zgjedhjeve mund ta përfshijnë edhe çështjen e pozitës së presidentit të Kosovës

PRISHTINË, 13 SHKURT - Rezultatet preliminare të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë nuk krijojnë mundësi për asnjë parti politike që ta formojë qeverinë e vetme. Njohësit e çështjeve politike thonë se koalicionet eventuale pas zgjedhjeve mund ta përfshijnë edhe çështjen e pozitës së presidentit të Kosovës. Mandati i presidentes aktuale, Vjosa Osmani, përfundon më 7 prill 2026. Bazuar në rezultatet preliminare, të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka marrë më së shumti vota, ka siguruar 47 ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa për formimin e qeverisë i duhen së paku 61. Partia Demokratike e Kosovës ka siguruar 25 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës 20 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 8. Nga 20 ulëset e mbetura në Kuvendin me 120 gjithsej, dhjetë janë të garantuara për komunitetin serb dhe dhjetë për komunitetet e tjera pakicë.

Çështja e presidentit, në dy nga tre skenarët për qeverinë

Analistët e çështjeve politike konsiderojnë se rezultati përfundimtar i zgjedhjeve mund të ndryshojë minimalisht, pas numërimit të votave nga jashtë Kosovës dhe të atyre me kusht. Por, bazuar në rezultatet aktuale, ata thonë se janë tre skenarë për formimin e qeverisë së re. Skenari i parë nënkupton një qeveri të formuar nga Lëvizja Vetëvendosje me komunitetet joserbe, një përfaqësues të komunitetit serb dhe ndonjë deputet nga tri partitë e deritashme opozitare. Një koalicion i Lëvizjes Vetëvendosje me njërin nga partitë aktuale opozitare, Partinë Demokratike të Kosovës ose Lidhjen Demokratike të Kosovës, si dhe me komunitetet joserbe, shihet

si skenar i dytë për formimin e qeverisë së re dhe krijimin e shumicës parlamentare. E si skenar i tretë konsiderohet një koalicion ndërmjet tri partive politike PDK, LDK, AAK dhe komuniteteve joshumicë serbe.

Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane thotë se, në rast se Lëvizja Vetëvendosje arrin ta formojë qeverinë e re me pakicat joserbe, çështja e pozitës së presidentit të Kosovës nuk do të jetë në tavolinën e “pazareve politike”.

Por, në të dy skenarët e tjerë ajo nuk do të mund të shmanget, sipas tij. “Në këta dy skenarët e tjerë, Lëvizja Vetëvendosje do të jetë së bashku me një parti tjetër shqiptare, apo opozita e gjitha së bashku. Këtu, pastaj, edhe posti i presidentit përfshihet në diskutime. Thjesht, sepse do të jenë më shumë aktorë të përfshirë dhe secili, me të drejtë, do ta kërkojë pjesën e vet të kulaçit”, thotë Shasha për “Radion Evropa e Lirë”. Megjithatë, ai thekson se pozita e presidentit të Kosovës nuk do të jetë interesi primar i subjekteve politike në kalkulimet për t’u përfshirë në formimin e qeverisë së re, por më shumë pjesë e plotësimit të një marrëveshjeje eventuale. “Interesi primar i tyre do të jetë pushteti ekzekutiv. Më duket se çështja e presidentit do të trajtohet më shumë si ato përfitimet e rendit të dytë”, vlerëson Shasha.

Zgjedhja e presidentit si “levë” për të shkuar në zgjedhje të reja?

Më ndryshe e sheh situatën Belgzim Kamberi nga Instituti për Politika Sociale “Musine Kokolari” në Prishtinë. Sipas tij, vetëm “një koalicion i madh” mund të bëhet shkak që çështja e presidentit të ardhshëm të vendit të përfshihet si pjesë e një marrëveshjeje politike. Zgjedhjen e presidentit Kuvendi i Kosovës duhet ta



votojë me dy të tretat e votave të 120 deputetëve sa i ka gjithsej. Në rast se kandidati për president nuk i merr këto vota në dy raundet e para, në raundin e tretë zgjidhet me votat e gjysmës së deputetëve. Në rast se Kuvendi dështon ta zgjedhë presidentin edhe në raundin e tretë, atëherë ai shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh. Kamberi thekson se, në rast se qeverinë e re e krijon Lëvizja Vetëvendosje me pakicat joserbe ose partitë aktualisht opozitare me pakicat joserbe, votat e domosdoshme për zgjedhjen e presidentit janë të pasigurta.

Mospajtimi i një ose dy deputetëve të pushtetit në atë rast, sipas tij, do ta dështonte zgjedhjen në raundin e tretë të votimit. Ai vlerëson se çështja e postit të presidentit ka pak gjasa të bëhet pjesë e ndonjë marrëveshjeje për ndonjë koalicion pas zgjedhjeve, përveç nëse arrihet ndonjë “koalicion i madh”. “Çështjen e presidentit, në këtë konstalacion, e zgjidh vetëm një koalicion i madh për qeverinë. Kur them ‘koalicion i madh’, e mendoj Vetëvendosjen me PDK-në

ose Vetëvendosjen me LDK-në. Kjo, aktualisht, më duket mundësia më pak e mundshme, përveç nëse ndodh ndonjë presion i madh ndërkombëtar, në këtë rast nga administrata amerikane”, thotë Kamberi për “Radion Evropa e Lirë”.

Në katër vjetët e fundit, Lëvizja Vetëvendosje ka qeverisur me pakicat joserbe. Pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, Vetëvendosja, PDK-ja dhe AAK-ja kanë deklaruar se e përjashtojnë mundësinë e koalicionit mes vete. Para zgjedhjeve, mundësinë e koalicionit me Vetëvendosjen e ka hedhur poshtë edhe LDK-ja. Kamberi i sheh të gjitha subjektet politike si të pakënaqura me rezultatet e arritura në zgjedhjet e 9 shkurtit sepse, sipas tij, as mandatarin për kryeministër nga Vetëvendosja, as nga opozita nuk do të mund të krijonte një qeveri stabile. Sipas tij, “pazari” për postin e presidentit më shumë do të bëhej pengesë sesa mjet për formimin e qeverisë së re.

Për më tepër, thotë ai, partitë politike do ta ruajnë çështjen e zgjedhjes së presidentit për më vonë, si levë për veprime të mundshme politike pas një

viti. “Mua më duket më shumë se jemi në një situatë ku partitë do t’i bëjnë kalkulimet e tyre për një afat të shkurtër politik elektoral, njëvjeçar, derisa të vijmë në situatën për zgjedhjen e presidentit dhe, vetëm pastaj, të kalkulojnë se çfarë u përshtatet më shumë. Pra, a ta çojnë vendin në zgjedhje apo t’i japin Kosovës një president të ri apo presidente të re”, thotë Kamberi.

Me Kushtetutën e Kosovës, presidenti i vendit gëzon mandat pesëvjeçar. Posti i tij është kryesisht ceremonial, por luan rol udhëheqës në politikën e jashtme dhe si komandant i forcave të armatosura. Presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, mori mandatin më 4 prill të vitit 2021, pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që u mbajtën më 14 shkurt të atij viti.

Me partinë e saj Guxo, që ka qenë në listë të përbashkët me Vetëvendosjen, Osmani ishte personi më i votuar në ato zgjedhje, me mbi 300 mijë vota. Ajo u zgjodh presidente nga Kuvendi i Kosovës në raundin e tretë të votimit, pasi mori 71 vota nga 82 deputetë sa ishin të pranishëm në seancën e zgjedhjes së saj.

Sylejman Selimi lirohet nga të gjitha akuzat, Haga ndërpret hetimet ndaj tij



HAGË, 13 SHKURT - Ish-komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sylejman Selimi, ka përfunduar dëshminë në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Nëpërmjet një njoftimi ai ka bërë me dije se të gjitha procedurat hetimore ndaj tij kanë përfunduar. “Sot përfundova dëshminë time në

Gjykatën Speciale në rastin ndaj z. Thaçi dhe të tjerëve. Pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë qenë dhe mbeten të përkushtuar ndaj drejtësisë, dhe këtë parim e kam dëshmuar edhe gjatë paraqitjes sime para trupit gjyqësor. Gjatë procedurës pranë Dhomave të Specializuara kam pasur edhe statusin e personit të dyshuar.

Me këtë rast, dëshiroj ta informoj publikun se të gjitha procedurat hetimore ndaj meje kanë pushuar”, ka thënë Selimi, duke shtuar se, gjithashtu, shpreh mirënjohjen e tij për avokatin Artan Qerkini, për këshillat profesionale dhe angazhimin e tij të palëkundur në mbrojtjen e të drejtave të mia gjatë gjithë procesit pranë Dhomave të Specializuara.

KOSOVA NË BISHT TË SORRËS TË INTERESIMIT NDËRKOMBËTAR



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Zgjedhjet përfunduan, çka tani: Ende nuk po dihen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, prandaj edhe po spekulohet aq shumë se kush dhe si do ta formojë qeverinë. Natyrisht që LV-ja në bazë të ligjeve në fuqi ka të drejtën e ius prima noctis, të drejtën e herës së parë apo natës së parë të propozojë qeverinë nëse i siguron 61 vota të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. E drejta e natës së parë më shumë ndërlidhet me aktivitetet seksuale e që shumë përkon me politikën në Ballkan dhe në Kosovë. Nëse mandatarin nuk siguron votat e mjaftueshme për qeveri i kalon presidentes si e drejtë diskrecionale e saj t'i japë mundësinë subjektivit tjetër ta formojë qeverinë. Realisht, ai mandatar që i siguron 61 nënshkrime të deputetëve që pastaj do të konfirmohen me votim në Kuvend, e formon qeverinë. Kjo do të ishte qeveri e super pakicës që nuk siguron as kushte minimale që ajo të përmbush premtimet dhe synimet. Do të krijohet një ngërç institucional, me një qeveri krejtësisht jofunksionale, të lëndueshme dhe buzë greminës - rrëzimit. Nëse situata nuk ndryshon, kështu qeverie do ta kemi. LV-ja edhe nëse i fiton 50 mandate, me 1 deputet të Llaple Sellës, Rashiqin nëse e merr një mandat dhe me 10 deputetë joserbë i bënë 61 vota apo qeveri të greminës që nuk do ta bëjë asnjë punë përveç se do të marrin rroga, mëditje dhe do të tredhin miza duke udhëtuar nëpër botë, pa prodhuar asnjë efekt. Po flasë me kusht nëse Kurti e mbanë fjalën duke mos bërë koalicion me asnjë parti shqiptare e as me Listën Serbe. Edhe opozita aktuale nëse nuk bën koalicion me Listën Serbe do ta formojë një qeveri, me ndoshta 63 deputetë, edhe kjo qeveri e greminës, me këmbë të thyera që lehtësisht do të rrëzohet. Edhe varianti i parë sikur edhe i dyti, më së shumti do të mbijetonin e jo qeverisnin, as edhe një vit të plotë shkaku se formimi i

qeverive të tilla i merr disa muaj. Në këtë raport forcash edhe pozita si dhe opozita do ta dërgonin vendin që zgjedhje të reja duke mos e siguruar kuorumin e nevojshëm për votim për zgjedhje të presidentit/ presidentes.

Si të dilet nga kjo situatë? Nëse dikush mendon se Albin Kurti do të heq dorë nga pushteti për ta tejkaluar bllokadën institucionale, e ka shumë gabim, nuk është në tokë të bukës. Albin Kurti do të provojë çdo mundësi ta formojë qeverinë qoftë edhe vetëm ne pakica duke lënë 53-55 deputetë shqiptarë në opozitë. Për Kurtin marrja edhe e një mandati qoftë edhe jo të plotë paraqet çështje të mbijetesës politike, partiake dhe, sigurisht që do të garantonte për aq kohë edhe siguri fizike apo imunitet nga ligji. Me një fjalë, në vend se të shkojë në Prokurori dhe të dëshmojë siç e parashihet ligji ai do t'i ftonë prokurorët në zyrën e tij për t'i marrë në pyetje pse iu kanë rënë në qafë ministrave të tij, ambasadorëve apo jaranave për ndonjë milion euro të shmangur e që është shumë e papërfillshme kur e krahasojmë me buxhetin 12 miliardë euro gjatë mandatit të plotë të regjimit të tij. Për ta penguar opozitën, nëse nuk i siguron votat për qeveri të ardhshme, Albin Kurti ka njëqindmijë mundësi procedurale ta prolongojë procesin, pa ardhur në kundërshtim me ligjin. Sigurisht se këto mundësi i ka planifikuar Kurti në mendjen e tij të mbrapshtë.

Dhe, çka pas kësaj? Në zgjedhjet e fundit me vota kanë rënë vetëm LV-ja dhe AAK - NISMA. Fituese e madhe është PDK-ja por as LDK-ja nuk konsiderohet humbëse sepse është rritur nga 12 për qind në 18 për qind, pa numërimin e votave të mbetura. Në asnjë parashikim timin nuk e kam parë LDK-në nën 21 për qind, pragu minimal e as AAK- NISMA nën 10 për qind gjithashtu pragu minimal. Për PDK-në kam parashikuar se

do të sillt kah 23 - 24 për qind. Prandaj kam menduar se LV-ja nuk e kalon 35 për qindëshin. Ashtu edhe do të bëhej, realisht po të rriteshin LDK-ja dhe AAK - NISMA. Në situatën aktuale që u krijua pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 dhe pas fyerjes jonormale që ua bëri Kurti opozitës, zgjidhja më e mirë do të ishte që opozita aktuale të qëndrojë në opozitë deri të zgjedhjet e radhës dhe, jo që nuk duhet ta pengojë Kurtin ta formojë qeverinë por, përkundrazi duhet të sigurojë votat e nevojshme në Kuvend për qeverinë Kurti 3, pastaj të mbetet në opozitë për ta lënë Kurtin ta bëjë rrugën qeverisëse bashkë me minoritetet joserbe dhe Listën Serbe. Nëse LDK-ja hynë në koalicion me LV-në do ta harrojë pësimin e vitit 2021 çka do ta pësonte në zgjedhjet e radhës. As PDK-në nuk do të duhej të bënte koalicion me LV-në, do ta pësonte keq dhe do të kishte rënie të madhe në zgjedhjet e radhës aq më parë që fuqia politike e LV-së, edhe pas këtyre zgjedhjeve është e madhe dhe kur të dojë apo ka përfitim, LV-ja e rrëzon qeverinë. Pastaj, zgjedhjet lokale janë afër, PDK-ja dhe LDK-ja si dhe AAK - NISMA duhet të bëjnë përgatitje të menjëhershme për të rritur numrin e votave. Sidomos kjo vlen për LDK-në që ka pësuar fijasko edhe në komunat që janë konsideruar si "Jerusalemi i LDK-së". Çdo lakmi e opozitës për të ardhur në pushtet në këto rrethana, aspak në favor të Kosovës e shkërrmoq opozitën ndërsa e forcon LV-në, pa asnjë dyshim. Nuk ka nevojë opozita ta rrezikojë shëndetin politik kur ka një përmirësim të ndjeshëm të shëndetit elektoral. LV-ja po thotë se populli përmes dhënies së 40 - 42 për qind të votave ua ka besuar edhe një mandat, mos i pengoni sepse do të jetë investim i mirë për të ardhmen e opozitës dhe rënie rapide e LV-së në ndërkohë që partnerët e koalicionit, minoritetet joserbe dhe LS-ja do t'i kenë mandatet e rezervuara dhe të garantuara. Bashkësia ndërkombëtare

në fuqinë dhe karizmën e Trampit, në fokus e ka Ukrainën dhe Gazën, Kosova është në bisht të sorrës. Pse opozita të merret me Grenellin dhe Trampin, le të merret Kurti me partnerët joshqiptarë të koalicionit! Pse opozita të hyjë në fushat e minuara nga Kurti i cili, vetëm ai e di ku i ka vendosur dhe mund t'i vë në veprim kur ta vlerësojë se përfiton politikisht dhe e dëmton opozitën, politikisht dhe me vota. Mina të kurdisura janë veriu i Kosovës, sanksionet ndërkombëtare, papunësia, rritja e varfërisë Marrëveshja e Brukselit dhe Ohrit, kapja e të gjitha institucioneve të mundshme, korrupsioni struktural institucional, nepotizmi pandemik si dhe inferioriteti turpëruar në skenën ndërkombëtare në raport me Serbinë. Nuk ka asnjë arsye që të pengohet nga opozita formimi i qeverisë Kurti 3 dhe janë njëqindmijë arsye që të mos bëjnë koalicion me Albin Kurtin, si hajvana të emërtuar nga vet Kurti.

A do të bëhet siç po e them unë? Kam frikë se jo. Sot bossi i NATO-s tha se sipas të gjitha gjasave, qeveria e ardhshme e Kosovës do të jetë qeveri e koalicionit. Këtë e tha edhe ambasadori gjerman në Kosovë. Me fjalë të lakurikuara, hiç atë diplomatik nënkupton se Kurti do të detyrohet të bëjë koalicion. Ata nuk e konsiderojnë koalicion atë të LV-së me minoritetet joserbe e as me LS-në. Madje as me AAK dhe NISMA. Ata e konsiderojnë koalicion nëse LV-ja lidhet me LDK-në apo me PDK-në. Pse, në siguri do të pyetni. Ndërkombëtarët konsiderojnë se ky koalicion siguron qëndrueshmëri dhe shmang zgjedhjet e reja në vitin e ardhshëm kur të vjen në rend dite çështja e presidentit/presidentes. Pastaj këtyre iu duhen garantues për aritjen përfundimtare të marrëveshjes me Serbinë si dhe zbatimin e saj e që do të kërkojë kompromise të mëdha. Prandaj, ma merr mendja se ndërkombëtarët do ta caktojnë

përbërjen e koalicionit sikur edhe arkitekturën e qeverisë, me ministra të filtruar nga vet ndërkombëtarët. Secili që do të kundërshtojë, pozitë apo opozitë mund të futet në listën e zezë si pengues të demokracisë apo moszbatues të marrëveshjeve dhe zotimeve ndërkombëtare. Nëse pengohet Kurti në formimin e qeverisë ai do ta luaj rolin e viktimës sikur të gjithë janë kundër tij. Në asnjë shtet të botës opozita nuk merr dhe nuk e ndanë përgjegjësinë me pozitën. Votojeni qeverinë Kurti 3, mund të jetë një humbje taktike por, pa asnjë dyshim do të jetë një investim shumë fitimprurës politik në të ardhmen për opozitën. Sigurisht Muja, jo ulqinaku por mitrovicalia nuk pajtohet me këtë parashikim timin. Madje, më thanë sepse nuk e kam lexuar se ma paska ndaluar të merrem me parashikime sepse paskam dëshnuar të LV-ja në zgjedhjet e fundit. Po, nuk kam qenë i saktë në parashikim, e pranoj, arsyet i tregova më lartë. Merreni me mend po të kishte fuqi Armend Muja të nënshkruaj urdhër ekzekutiv si Donald Tramp, së çka do të bënte me në që nuk jemi në skemën e LV-së! Por, lexues të nderuar krahasojeni marzhën e gabimit tim për LV-në në zgjedhjet e fundit ne parashikimin e Mujës për zgjedhjet e fundit lokale ku thoshte se LV-ja i fiton sigurisht 21 e fiju komuna ndërsa i fitoi vetëm tri (3)! Albin Kurti do t'i lusë partitë opozitare të bëjnë koalicion me te, si kusht i mbijetesës, partiake dhe personale. Fort do të dashurohet me hajvanët e opozitës dhe në vend të socialdemokracisë liberale do ta kthejë kohën e hajvanatit. Albin mo, nuk e ka për herë të parë e as të fundit. Për të larë m.t me sh...ë, po i shkruan BE-së letër për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës në kohën kur vet ua shkelë këto të drejta duke i bërë pikë e pesë. Çfarë mashtrimi dhe zhvendosje e vëmendjes!

Të burgosurit fillojnë krasitjen e mollëve në Qendrën Korrektuese të Dubravës

PRISHTINË, 13 SHKURT - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se në kuadër të aktiviteteve bujqësore në Qendrën Korrektuese të Dubravës ka filluar procesi i krasitjes së

mollëve në plantacion. Ky aktivitet po realizohet nga të burgosurit, nën mbikëqyrjen e stafit përgjegjës. "Angazhimi i të burgosurve në këto aktivitete ka për qëllim jo

vetëm mirëmbajtjen e plantacionit, por edhe aftësimin e tyre në sektorin e bujqësisë", thuhet në njoftimin e ShKK-së. ShKK shton se ky aktivitet është pjesë e iniciativave për

rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve, duke u mundësuar atyre të fitojnë aftësi të reja që mund t'i shfrytëzojnë pas përfundimit të dënimit.



Ish-ambasadori Peci: Kosova ka hyrë në periudhën më të paparashikueshme politike

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 SHKURT - Ish-ambasadori i Kosovës në Suedi, Luzim Peci, njëherësh drejtor i Institutit KIPRED, ka thënë se Kosova me vetëdije të plotë e ka futur veten në periudhën më të paparashikueshme politike që nga shpallja e pavarësisë. "Në vend që draft-statuti i Asociacionit të dërgohej në Gjykatën Kushtetuese dhe sot të ishim anëtarë të Këshillit të Evropës, me rrugë të hapura për integrim të mëtejshëm në BE dhe me mundësi për marrëdhënie më të ngushta me NATO-n, ne vendosëm të bënim të kundërtën, duke e armiqësuar veten me gjithë Perëndimin. Sot, kur po ndodhin lëvizje tektonike në rendin botëror, ia kemi plotësuar dëshirën Rusisë, e cila vazhdimisht ka deklaruar

se marrëveshja Kosovë - Serbi duhet të ndodhë pas arritjes së një marrëveshjeje për përfundimin e luftës në Ukrainë", ka shkruar Peci në "Facebook".

Ai ka thënë se tani parametrat e rendit të ri botëror dhe të kornizës së sigurisë evropiane po ravijëzohen nga përfundimi i kësaj lufte, e cila mund të pasohet edhe nga një çarje e madhe transatlantike. "Çfarë do të thotë kjo për Kosovën, do ta shohim së shpejti! Cilado qoftë rrjedha që do të marrë marrëveshja Kosovë - Serbi, mos u ankoni, sepse këtë e kemi dëshiruar vetë. Derisa merreshim me taktika politike, si hapja e urës së Ibrit, e cila mbeti e mbyllur, nuk e shihnim malin për shkak të një druri. Kështu përfundon kur veshët dëgjojnë vetëm atë që duan të dëgjojnë", ka shkruar Peci.



Murati: Administrata Trump 2 ka zënë në befasi fqinjët e ShBA-së, ndërsa Kosovën? Indiferente



PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim dhe profesor universitar, Valon Murati, thotë se presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ndonëse shumicën e politikave që po i ndjek me shpejtësi dhe dinamikë të paparë i ka thënë në fushatë, prapëseprapë bota vazhdon të mbetet gojëhapur. Murati ka shkruar në "Facebook" se administrata Trump 2 ka zënë në befasi fqinjët e ShBA-së, ndërsa Kosovën indiferente. "Ka zënë në gjumë krejt botën arabe. Ka zënë të papërgatitur dhe në


kaos Evropën. Ka zënë në pozitë pa përgjigje (për të mos thënë të pashpresë) Ukrainën. Ndërsa ne? Ne na ka zënë indiferentë. Indiferencë që vazhdon me komoditet, sikur të jemi qendra e botës, e jo një vend i brishtë i cili nëse di të pozicionohet dhe e di çfarë do, mund të përfitojë nga ndryshimet në rendin ndërkombëtar, e nëse vazhdon me indiferencë edhe mund ta pësojë (me izolim, injorim, destabilizim e moszhvillim)", ka shkruar Murati në "Facebook".

Kryetari i Gjilanit akuzon LDK-në dhe PDK-në për bojkot e bllok buxhetit të qytetarëve

GJILAN, 13 SHKURT - Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se pas javësh të tëra bllokade nga opozita dhe thirrjeve të tij të vazhdueshme drejtuar fillimisht asamblistëve të partive opozitare dhe më pas edhe kryetarëve të këshilltarëve komunalë, dje ka ftuar një

takim urgjent kryetarin e Degës së LDK-së në Gjilan dhe kryetarin e Degës së PDK-së në Gjilan, të cilët nuk i janë përgjigjur ftesës. "Në këtë takim i kam ftuar z. Lutfi Haziri, kryetar i Degës së LDK-së në Gjilan, dhe z. Riad Rashiti, kryetar i Degës së PDK-së në Gjilan, për të

diskutuar buxhetin e komunës dhe ngërçin institucional me të cilin po përballemi. Qytetarët e Gjilanit vlerësojnë drejt e nuk harrojnë. Po u bëjë thirrje përsëri, që të reflektoni e të përgjigjeni në kërkesën qytetare për votimin e buxhetit!", ka shkruar Hyseni në "Facebook".



Demokratët dhe republikanët mbi pezullimin e fondeve të USAID-it

WASHINGTON, 13 SHKURT - Ligjvënësit demokratë amerikanë thanë të mërkurën se pezullimi i ndihmave për vendet e huaja nga administrata e presidentit Trump mund ta dëmtojë përgjithmonë sigurinë dhe ndikimin e Shteteve të Bashkuara në botë. Siç njofton korrespondentja e Zërit të Amerikës, Katherine Gypson, republikanët po i kundërshtojnë kritikën, duke thënë se rishikimi i programeve të Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar është i nevojshëm për t'i luftuar abuzimet. Ndërsa Shtetet e Bashkuara po shqyrtojnë programet e ndihmave për vendet e tjera,

gjithë bota po ndien pasiguri. "Ne po humbasim dekada përvojë dhe njohuri, marrëdhënie të krijuara, ndërhyrje efektive në disa nga vendet më të rrezikshme dhe më të largëta në planet si dhe po tradhetojmë partnerët që kanë rrezikuar statusin në komunitetet dhe vendet e tyre, duke u rreshtuar publikisht me ne", thotë Chris Coon, senator demokrat.

Ekspertët u thanë ligjvënësve gjatë një diskutimi të mërkurën se ndihma për botën e jashtme përfaqëson më pak se një për qind të buxhetit total të Amerikës. Ata kundërshtuan pretendimet se fondet federale janë shfrytëzuar për programe pa vlerë. "USAID-i ka qenë



objektivi i një fushate të bashkërenduar dezinformimi, të udhëhequr nga Elon Musk dhe të përforcuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara. Ata kanë hedhur pretendime të rreme e shpifje kundër një agjencie, misioni i së cilës është thelbësor për

avancimin e interesave të Amerikës në botë", thotë Jeremy Konyndyk nga organizata 'Refugees International'. Republikanët kanë mbrojtur punën e Departamentit të Efikasitetit të Qeverisë të udhëhequr nga miliarderi Elon

Musk, duke thënë se përpjekjet për ta ndaluar mashttrimin dhe shpërdorimin janë shumë të vonuara. "USAID-i është një agjenci që na ka zhgënjyer të gjithëve. Kam mbrojtur ndikimin e tërthortë të Amerikës në botë përmes këtyre fondeve gjatë gjithë kohës sime si senator, por ajo që kam parë më neverit", thotë senatori republikan Lindsey Graham.

Administrata Trump ka lejuar që disa programe të ndihmës të rifillojnë, por senatorët demokratë ngritën pikëpyetje të mërkurën nëse një gjë e tillë është e vërtetë. Ndihmat për botën e jashtme mbështesin mbi 100 000 vende pune në Shtetet e Bashkuara.

"Pastrimi", akuza për komunën e Prishtinës: Keni vendosur që menaxhimi i mbeturinave t'i jepet një kompanie private dhe të eliminohet 'Pastrimi'

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" ka hedhur poshtë të enjten akuzat e komunës së Prishtinës, ndërsa fajësojnë komunën se po mban peng dy kamionë. "Është e papranueshme dhe e turpshme që komuna e Prishtinës po mban 'peng', dy kamionë për mbledhjen e mbeturinave, duke mos i vënë në funksion për qytetin. Dyshimet janë të bazuara: kjo po bëhet për t'i dorëzuar më vonë një kompanie private, e cila pritet të operojë me to. Ky është një keqpërdorim flagrant i pushtetit për interesa private, që tregon qartë prapavijën e vendimeve të kryetarit Rama. Deklarata juaj, z. Rama, ku paralajmëroni 'masa të menjëhershme dhe të ashpra ndaj kompanisë 'Pastrimi' për shkak të dështimit të tyre të pafalshëm dhe sabotimit të qëllimshëm', është një përpjekje e hapur për të manipuluar opinionin publik



dhe për të krijuar një krizë artificiale. Ju rikujtojmë se ndërmarrja 'Pastrimi' është ndërmarrje publike që i përgjigjet Kuvendit Komunal dhe jo dëshirave të një individi. Prishtina nuk është pronë private, dhe as ju nuk mund ta trajtoni atë si të tillë", është thënë në reagimin e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi". Kjo kompani ka theksuar se sa iu përket akuzave tuaja për dëmtimin e gjashtë kamionëve, kjo nuk është e vërtetë. "Në prani të kamerave

të mediave të ndryshme, ne i kemi testuar dhe nuk janë ndezur dhe ju Komuna është dëshmitarë për këtë. Ne ju kemi shkruar email zyrtar që në fillim, duke ju informuar për problemet teknike të kamionëve, sepse duket se ato nuk janë testuar kur i keni blerë dhe kanë pasur probleme të tilla që nga fillimi disa probleme në sistemin elektronik të kompaktorit dhe se deri më tani, nuk keni ndërmarrë asnjë veprim kur dihet se kamionët janë pronë e Komunës dhe kushtet e

kontraktimit dhe garancionit janë të lidhura nga ju. Në vend që të ndihmoni në zgjidhjen e këtij problemi, ju keni zgjedhur të gënjeni para mediave duke na akuzuar se ne i kemi dëmtuar kamionët. Kjo është e turpshme. Pastaj, sot pas konferencës për media, na keni kthyer emailin zyrtar duke thënë se shpërndarja e kontejnerëve mund të fillojë sot. Kjo ndodhi vetëm pasi gazetarët ju pyetën në konferencë se pse nuk po i shpërndani kontejnerët", theksohet në reagim.

Kompania "Pastrimi" ka thënë se nuk është më sekret që komuna e Prishtinës ka vendosur me çdo kusht që menaxhimi i mbeturinave t'i jepet një kompanie private dhe që "Pastrimi" të eliminohet plotësisht. "Kjo nënkupton që mbi 900 punëtorë do të mbeten pa punë, por kjo duket se nuk përbën problem për ju. Fondi prej 16 milionë eurosh është shumë i konsiderueshëm dhe,


për fat të keq, po trajtohet më shumë si një mundësi për të shlyer borxhe të tjera sesa si investim në shërbime më të mira për qytetarët. Pavarësisht këtyre përpjekjeve për bllokim, ne po punojmë për ta mbajtur qytetin pastër. Lusim qytetarët të na lajmërojnë për çdo rast ku mbeturinat nuk janë mbledhur, dhe ne do të vazhdojmë ta kryejmë detyrën tonë. Qytetarët janë prioriteti ynë dhe ata nuk duhet të preken nga kjo krizë artificiale. Është obligimi ynë të mbajmë qytetin pastër, bashkë me qytetarët. Përpjekjet e komunës për të bllokuar çdo gjë janë të papranueshme, por qytetarët nuk duhet të jenë viktimë të kësaj loje politike e personale të kryetarit. Ata meritojnë një qytet të pastër dhe funksional, dhe ne do të bëjmë gjithçka që ky shërbim të mos ndalet, pavarësisht pengesave të krijuara nga pushteti aktual", është theksuar në reagimin e Kompanisë "Pastrimi".

ZKA-ja auditon menaxhimin e fondeve për burimet e ripërtërishme të energjisë

PRISHTINË, 13 SHKURT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës me temën "Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë", i cili është pjesë e planit vjetor të auditimit për periudhën 2024/2025. Auditimi ka në fushëveprim Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Ministrinë e Ekonomisë (ME) si dhe synon ta vlerësojë efikasitetin e menaxhimit, monitorimit dhe

zbatimit të masave për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme. Kosova si nënshkruese e Traktatit për Komunitetin e Energjisë ka vendosur objektiva për rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe ka krijuar skema mbështetëse për investime në këtë fushë. Megjithatë, ka sfida lidhur me funksionimin dhe efektivitetin e këtyre skemave. Prandaj përmes këtij auditimi ZKA synon t'i vlerësojë rolet dhe performancën e institucioneve

përgjegjëse në zbatimin e detyrimeve dhe politikave, integrimin e energjisë së ripërtërishme në sistem dhe zhvillimin e një tregu transparent e të qëndrueshëm. Ky auditim ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të resurseve energjetike dhe përmbushjen e objektivave strategjike të vendit në këtë fushë. Zyra Kombëtare e Auditimit mbetet e përkushtuar për të siguruar që pasuritë natyrore të menaxhohen në mënyrë transparente dhe efektive.



E vërteta 'barbare' e Betejës së Mogadishusë

Në vitin 1993, 18 paqeruajtës amerikanë u vranë nga milicët somalezë. Çfarë shkoi keq – dhe a ishte ky një “precedent i rrezikshëm”?



Nga: Colin FREEMAN /
The Daily Telegraph
(titulli: *The 'barbaric' true story of Black Hawk Down*)

Rreshteri Kenneth Thomas kujton momentin kur incidenti Black Hawk Down [rënia e helikopterit amerikan Black Hawk – Skifteri i Zi; fjala është për atë që njihet si Beteja e Mogadishusë e 3 dhe 4 tetorit 1993], në Mogadishu, filloi të ndihej si një skenar filmi. Ishte 3 tetori i vitit 1993, dhe pas një sulmi në strehën e kreut të luftës, në qendër të kryeqytetit Mogadishu, ai dhe rreth 100 trupa të tjerë amerikanë u gjendën të rrethuar nga mijëra milicë somalezë.

“E quanim si një moment Holivudi, sepse nuk kishim parë asgjë të ngjashme, përveçse në filma”, kujton Thomasi, 59 vjeç, i cili i ishte bashkuar Ushtrisë amerikane vetëm dy vjet më parë, duke ndjekur hapat e të atit që ishte veteran i Luftës së Vietnamit. “Kishte kaq shumë të shtëna në çdo drejtim, plumba që vinin, plumba që shkonin. Nuk mbaj mend veten nëse ndihesha i tronditur – por, pastaj njerëzit qëlloheshin me plumba dhe binin”.

Pikërisht atëherë ndodhi që

skenari i Holivudit të marrë një kthesë të gabuar, kur “të këqijtë” ishin shumë pranë fitores. Në betejën 18-orëshe që pasoi, 18 trupa amerikanë u vranë dhe 73 të tjerë u plagosën, duke e bërë këtë aksion të jetë episodi më vdekjeprurës i ushtrisë amerikane që nga Lufta e Vietnamit. Për ta shtuar tmerrin, trupat e ushtarëve u tërhoqën zvarrë nëpër rrugë nga milicët që brohorisnin. Katër ditë më vonë, presidenti Bill Clinton

njoftoi tërheqjen e ShBA-së, duke marrë me vete një mësim të hidhur mbi rreziqet e ndërhyrjeve në vendet e tjera.

E gjithë historia është dokumentuar tashmë në detaje, fillimisht nga Mark Bowden në bestsellerin e tij të vitit 1999, Black Hawk Down, dhe më pas nga Ridley Scott në filmin e tij të vitit 2001 me të njëjtin titull. Fuqia e vazhdueshme e kësaj ngjarjeje, tani është trajtuar edhe nga një dokumentar në

Netflix – një serial i ri me tri pjesë që aktualisht po transmetohet.

Surviving Black Hawk Down është një rrëfim gjithëpërfshirës – një pranim se edhe pas ndalimit të të shtënave, beteja mbi narrativën historike vazhdon. A ishte kjo një humbje poshtëruese për superfuqinë kryesore të botës, siç shumë vetë pretenduan? Apo ishte, siç thonë disa veteranë amerikanë, si rreshteri

Thomas, një histori e përgjakur heroizmi, ku ata rezistuan përballë gjasave të pamundshme? Si u perceptua nga somalezët – a ishin ata krenarë që mundën fuqinë e madhe amerikane, pavarësisht se kjo e përshpejtoi rënien e kombit të tyre në dekada anarkie?

Këto pyetje më është dashur t'i shqyrtoj, personalisht, kur vizitova për herë të parë Mogadishun si korrespondent i ditores The Telegraph në vitin 2006, ku mbetjet e një prej helikopterëve ende qëndronin në kopshtin e pasmë të një gruaje të njohur si “Zonja Black Hawk Down”. Për një tarifë, ajo lejoi gazetarët të fotografonin rrënojat – një simbol i djegur dhe i dërrmuar se si Somalia ishte shndërruar në një zonë të rrezikshme dhe pa ligj. Dy vjet më vonë, e përjetova personalisht atë mungesë ligji, duke kaluar gjashtë javë i rrëmbyer në një shpellë, ndërsa raportoja mbi epideminë e piraterisë në Somali. U lirova pa dëme të mëdha, por pata mjaft kohë për të menduar nëse Somalia do të kishte pasur një fat më të mirë nëse helikopterët Black Hawk nuk do të ishin rrëzuar atë ditë.

Nuk e kam asnjë ide nëse



Rrënojat e helikopterit Black Hawk në qendër të Mogadishut (Foto: Scott Peterson)

mbetjet e helikopterit janë ende aty, por shumica e somalezëve mbi 40 vjeç, ruajnë të gjalla kujtimet nga dita kur u rrëzua.

“Ashtu siç të gjithë në Britani mbajnë mend ditën se ku ishin kur vdiq princesha Diana, çdo njeri në Mogadishu e di se ku ndodhej më 3 tetor 1993”, thotë Jack McInnes, regjisori i dokumentarit Surviving Black Hawk Down i cili intervistoi vendasit, trupat amerikane dhe ish-milicët. Ai punoi së bashku me producentin britanik dhe reporterin e Channel Four, Jamal Osman, i cili ka lindur në Somali dhe ka kontakte të mëdha atje. Megjithatë, edhe sot, kryeqyteti somalez mbetet një vend i rrezikshëm për ekipet perëndimore të xhirimit, prandaj, gjatë realizimit të dokumentarit, shumë pjesëmarrës u dërguan për intervista në Keninë fqinje.

Nuk është për t'u habitur që të dyja palët japin perspektiva shumë të ndryshme, por ngjarjet që çuan në incident ndodhën afërsisht si më poshtë.

Pas shpërthimit të luftës klanore, pas rrëzimit të diktatorit somalez të mbështetur nga sovjetikët, Siad Barre, në Mogadishu u dërgua një forcë paqeruajtëse e OKB-së me



Piloti amerikan Michael Durant evakuohet pas lirimt nga Aideed (Foto: Hocine Zaourar / AFP)

pothuajse 40 mijë trupa, nga të cilët tri të katërtat ishin amerikanë, për të ndaluar krerët e luftës të plaçkitnin ndihmat për ta ndaluar urinë. Ajo që fillimisht dukej si një version ushtarak i Live Aid [rok-koncerti humanitar i vitit 1985], më pas u shndërrua në luftë për pushtet me krerët e luftës, veçanërisht me Mohamed Farah Aideedin, forcat e të cilit kishin luajtur një rol kyç në rënien e Barresë. Në një vend ku rregulli ishte i lidhur

me armën, Aideedi e ndjente veten të ligjshëm për të qenë pasardhës i Barresë dhe kishte frikë se mbështetja e OKB-së për zgjedhje shumëpartiake do të pengonte qëllimet e tij.

Të dyja palët, paqeruajtësit dhe milicët somalezë akuzuan njëri-tjetrin për mizori. Në qershor 1993, forcat e Aideedit u fajësuan për një pritë ku u vranë 24 trupa pakistaneze. Një muaj më vonë, helikopterët amerikanë bombarduan një

shtëpi në Mogadishu ku mendohej se ndodheshin njerëzit e Aideedit, por u akuzuan për vrasjen e dhjetëra pleqnarëve të klaneve që po flisnin për paqen.

Pavarësisht se cila ishte e vërteta, kjo i ktheu shumë somalezë kundër pranisë së huaj. Kështu, në një sulm mbi një tjetër strehë të Aideedit në tetor, forcat amerikane zbarkuan trupat me helikopterë për të thyer me shkëlqim një derë, në vend

që ta bombardonin nga distanca, sepse donin të shmangin viktimat e pafajshme. Plani ishte të fluturonin mbi ndërtesë dhe të zbrisnin me litar nga 20 metra lartësi – por, siç kujton rreshteri Thomas, aty filluan të shfaqeshin problemet.

“Shpejt me litarë nënkupton thjeshtë rrëshqitjen me dorëza, pa ndonjë litar sigurie apo pajisje për alpinistë”, më thotë ai në telefon nga ShBA-ja. “Por, një nga shokët e mi nuk e kapi litarin, sepse helikopteri u zhvendos për të shmangur të shtënat, dhe ai ra nga 15 metra lartësi duke thyer shtyllën kurrizore. Që në fillim, misioni po merrte një kthesë të rëndë”.

Megjithëse fillimi ishte i pasigurt, ai thotë se sulmi ishte i suksesshëm, duke kapur një duzinë ndihmësish të Aideedit brenda gjysmë ore, të cilët do të ngarkoheshin në një kolonë me Humvee [makinë e blinduar ushtarake] që kishte rrethuar ndërtesën. Pastaj, pak minuta më vonë, ndodhi e paimagjinueshmja: helikopteri i parë nga tre Black Hawk u rrëzua nga një bazukë – diçka që pak e kishin menduar si të mundur për shkak të shpejtësisë së madhe të helikopterëve. Por,



Rreshteri Kenneth Thomas (majtas) me pjesën tjetër të ekuipazhit të tij në Mogadishu (Foto: Kenneth Thomas)



forcat e Aideedit, duke përdorur teknikat e zhvilluara nga muxhahedinët afganë, kishin gërmuar gropa të fshehura për të qëlluar direkt në qiell, ndërsa kokat e bazukave ishin modifikuar për të shpërthyer në ajër në vend që të kërkonin një goditje të drejtpërdrejtë

Që nga ai moment, grupi sulmues duhej gjithashtu të vepronte si një forcë shpëtimi për ekuipazhin e helikopterit të rrëzuar, megjithëse edhe atëherë rreshteri Thomas ishte i sigurt se do të fitonin. Armiku, në fund të fundit, nuk ishte një forcë elitare si njësitë Rangers dhe Delta Force, por thjesht “djem me shapka në pjesën e pasme të kamionçinave”, të cilët në shumicën e rasteve nuk dinin as të qëllonin siç duhet. Megjithatë, milicët e çorganizuar kishin një avantazh që shumica e ushtarëve të huaj nuk e kishin.

“Këta burra amerikanë nuk kishin qenë kurrë në një betejë të vetme”, thotë milici Yasin Dheere, në dokumentar. “Ishin djem shkollash. Unë isha një luftëtar me 30 apo 40 beteja mbi supe”.

Dhe, me të vërtetë, ajo që somalezëve u mungonte në teknikë, e kompensonin me shpirtin luftarak dhe kështu filloi të mbizotëronte forca numerike. Shoku i Thomasit, Earl Fillmore, u vra vetëm pesë metra larg tij, ndërsa

përpiqeshin të arrinin te helikopteri i rrëzuar.

“Nëse nuk beson se ka një shpirt brenda trupit të njeriut, atëherë nuk ke qenë aty kur dikush vdesë”, thotë Thomas. “Sepse, 60 sekonda më parë, ai ishte Earli. Dhe, pastaj, kur arrita tek ai, ai thjesht dukej si një figurë muzeale prej dylli e një njeriu që dikur njihja”.

Ndërkohë që mbështetësit e Aideed vërshuan nga gjithë Mogadishu për t’u bashkuar në luftë, erdhi radha e amerikanëve të ndiheshin si pre të rrethuara, ndërsa milicët bllokoi rrugët e arratisjes nëpër rrugicat e ngushta të qytetit.

“Paramendo të përpiqesh të kthesh një automjet në një rrugicë të ngushtë gjatë një përleshjeje me armë”, thotë specialisti Brad Thomas, i cili po përpiqej të evakuonte të plagosurit me një Humvee. “Ne përballëshim me një bllokadë pas tjetres ... duke u endur në qark nëpër rrugë, ndërkohë që na qëllonin”.

Një tjetër ushtar, i identifikuar vetëm si “Dave” në dokumentar, pranon se kishte qëlluar mbi turmat e somalezëve. “Nuk kam asnjë problem ta them, sepse kishte njerëz që na qëllonin nga ato turma, dhe unë nuk mund të rrija ulur aty e të merrja vesh se kush po më gjuan”, thotë ai. “Nëse ishe atje më 3 tetor, nuk të priste asnjë e mirë”.

“Ishte çmenduri, ishte barbari”, shton specialisti

Thomas, i cili thotë se “u përpoqa të vrisja këdo që mund të shihja që ishte armiqësor ose vepronte në mënyrë armiqësore”.

Dhe, situata ishte gati të bëhej edhe më barbare. Një kolonë shpëtimi e udhëhequr nga tanket pakistaneze, më në fund ndihmoi trupat e rrethuara të ktheheshin në bazë, vetëm për të parë lajmet ku trupat e shokëve të tyre të vdekur po tërhiqeshin zvarrë nëpër rrugë. “Të gjithë po bërtisnin drejt televizorit se ‘çfarë drejtin është kjo’”, thotë Specialisti Thomas. “Ishte absolutisht e neveritshme dhe thash me vete: ‘Familjet e këtyre njerëzve po e shohin këtë’”.

Natyrisht se po. Në ShBA, Carmen Gordon, gruaja e nënrreshterit Gary Gordon, sapo ishte informuar se ai ishte shpallur “I zhdukur në aksion” – një term që nuk e kishte dëgjuar të përdorej që nga Lufta e Vietnamit. Pastaj, ajo pa në lajme pamjet makabre të trupave të tërhequr zvarrë në rrugët e Mogadishut. “Nuk mund ta kuptoja se si njerëzimi mund të ishte kaq mizor”, thotë ajo. Ndërkohë, gjithashtu u shfaqën videot e pilotit të kapur të helikopterit Black Hawk, Mike Durant, i cili në një moment u rrah me kraun e prerë të një shoku të ekuipazhit. “Mendova se nuk ka asnjë rrugëdalje nga këtu, se do të vdes”, kujton ai. Pas negociatave të fshehta, Durant u lirua në një “gjest të


vullnetit të mirë” nga Aideedi, i cili kishte frikë nga hakmarrja e ShBA-së. Gjithsesi, gjashtë muaj më vonë, gjithë trupat amerikane ishin larguar, me forcat e tjera të OKB-së që ndoqën shpejt shembullin e ShBA-së. Somalezët pësuan deri në 500 të vrarë dhe 1 000 të plagosur, por disa ende këmbëngulin se kjo ia vlente. “Edhe nëse vdiqën 1 000 njerëz, nuk kishte rëndësi”, thotë luftëtarë Nuur Hassan, i cili mori armët pasi u keqtrajtua në një postbllok të OKB-së. “Qëllimi ynë ishte liria e Somalisë”.

Por, ndërsa luftëtarët e Aideedit festonin fitoren, vendi vuajti në planin afatgjatë. Pas tërheqjes së OKB-së, Somalia u braktis nga komuniteti ndërkombëtar, duke mbetur pa një qeveri funksionale për gati dy dekada, ndërsa piratët dhe islamistët përfituan nga boshllëku i pshetit. Vetë Aideedi u vra nga një snajper në Mogadishu tre vjet më vonë. Trauma e Black Hawk Down pati pasoja në mbarë Afrikën, duke kontribuar në hezitimin e Uashingtonit për të ndërhyrë ushtarakisht gjatë gjenocidit në Ruandë në vitin 1994, ku u masakruan deri në 800 mijë njerëz. Ajo përndoqi gjithashtu politikëbërësit amerikanë gjatë vendimarrjes për Luftën e Bosnjës (1992-1995), një konflikt brutal në zemër të Evropës, ku u vranë mbi 100

mijë njerëz. Në fakt, ShBA-ja nuk rifitoi besimin për ndërhyrje të mëdha ushtarake në terren, deri në Afganistan në vitin 2001, dhe incidenti Black Hawk Down mbetet edhe sot një “mësim i nxjerrë” në qarqet ushtarake të ShBA-së.

Për rreshterin Thomas, i cili u largua nga ushtria katër vjet më vonë dhe tani është këngëtar i muzikës kantri dhe folës motivues, humbja e vetëbesimit të Amerikës ishte ndoshta kostoja më e madhe. Çdo dhjetë vjet, ai dhe bashkëluftëtarët e tij mbledhen për një ribashkim, ku ende kujtojnë me krenari atë ditë fatale. Megjithatë, nëse ka diçka për të cilën pendohet, është fakti se liderët politikë të Amerikës humbën vullnetin për të vazhduar misionin në Somali. Hija e Black Hawk Down-it vazhdon të ndihet edhe pas më shumë se dy dekadash – platforma e fundit zgjedhore e Donald Trumpit ishte e mbështetur fort në izolacionizmin amerikan dhe dëshirën për t’i dhënë fund “të gjitha luftërave të huaja”.

“Ishte një gabim për Amerikën të tërhiqej nga bota, dhe do ta përmendja Ruandën si shembull për këtë”, thotë ai. “Kjo vendosi një precedent të rrezikshëm – që nëse i shkakton një superfuqie humbje të përgjakshme dhe tërheq trupat e tyre zvarrë në rrugë, publiku amerikan nuk ka durim për ta vazhduar tutje”. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kurti për finalen e Kupës: Pamë një ndeshje fantastike dhe tifozë të flaktë

Lindon Emërllahu u paraqit edhe zyrtarisht të martën nga CFR Cluj, të cilit iu bashkua për 700 mijë euro nga Ballkani.

Futbollisti më i mirë i vitit 2024 në Kosovë ka folur për herë të parë si futbollist i ri i Clujit, me të cilin synon ta ketë një

përvojë të suksesshme. "Jam i lumtur që jam këtu, në një klub të madh si CFR Cluj, i cili vit pas viti gjendet në krye të

tabelës. E kam përcjellë skuadrën në këtë sezon dhe dua që së bashku të kemi momente të mira. Do të jap

gjithçka nga vetja për ekipin, për tifozët dhe për këto ngjyra që t'ia dalim të jemi kampionë sërish", ka thënë Emërllahu.

Labinot Haziri emërohet trajner i 2 Korrikut

"Epoka e re"

PRISHTINË, 13 SHKURT - Vetëm një ditë pasi u konfirmua largimi i trajnerit Besim Ademi nga skuadra e 2 Korriku nga Prishtina, kryeqytetasit kanë zyrtarizuar trajnerin e ri, i cili është Labinot Haziri. Ky i fundit pjesën më të madhe të karrierës si futbollist dhe trajner e ka kaluar në klubin e 2 Korrikut. Trajneri Haziri, i rritur si futbollist e trajner në klubin kryeqytetas të 2 Korrikut, vjen në ekipin senior pas sukseseve të njëpasnjëshme në futbollin e të rinjve në Kosovë, duke u shpallur kampion i Kosovës me moshat U13, U15, U17 dhe U19, e duke arritur një sukses të jashtëzakonshëm me ekipin junior në garat e prestigjiozes evropiane, UEFA Youth League, ku arriti që t'i kaloi dy raunde e t'i fitoj katër nga gjashtë ndeshjet e zhvilluara. "Me vendim të Bordit Drejtues, nga 2 Korriku afrimin e trajnerit të ri e konfirmon drejtori Gjeneral, Shaban Baholli, i cili mes tjerash e vlerësoi shumë faktin që një trajneri perspektiv i është ofruar një mundësi e tillë. Labinot Haziri, i lindur më 01.01.1992, ka plot dhjetë vite që angazhohet si kryetrajner, duke arritur kështu përvojë shumë të vlefshme në sportin e futbollit, gjë të cilën do të angazhohet që ta transmetoj edhe në futbollin senior", thuhet në njoftimin e 2 Korrikut. Ndërsa në anën



tjetër trajneri me perspektivë në futbollin kosovar, është shprehur i lumtur me mundësinë dhe besimin e dhënë. "Për mua do të thotë shumë dhënia e mundësisë që ta drejtoj ekipin senior të klubit të 2 Korrikut, klub në të cilin e kam kaluar pjesën më të madhe të karrierës sime si

futbollist por edhe si trajner. Jam i vetëdijshëm për sfidat që na presin, mirëpo me besim të plotë tek skuadra dhe bashkëpunëtorët do t'i arrijmë objektivat në fund të këtij sezoni", ka thënë Haziri, i cili të enjten paradite e ka zhvilluar stërvitjen e parë me ekipin senior të 2 Korrikut.

SHKURT

Në Pejë po mbahet Kampi Ndërkombëtar i Xhudos

Në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë po mbahet Kampi Ndërkombëtar i Xhudos. Në këtë Kamp po marrin pjesë xhudistë e xhudiste nga shtetet si: Shqipëria, Bullgaria, Bosnjë-Hercegovina, Republika Çeke, Mali i Zi dhe klubet nga Kosova. Kampi po udhëhiqet nga kryemjeshtri Driton Kuka dhe trajnerët Majlinda Kelmendi e Fatos Tabaku. Ky Kamp organizohet në kuadër të programit shtetëror, "Kosova, shtet i xhudos", nën komponentin "Diplomacia publike", që ka për qëllim zhvillimin e diplomacisë së Kosovës përmes sportit të xhudos.

Xhaka: Do ta mundim Bayernin dhe do ta rihapim kampionatin

Granit Xhaka beson se skuadra e tij do të arrijë të triumfojë kundër Bayernit në supersfidën e fundjavës në Bundesligë. Kampionët në fuqi të turneut nuk kanë mundur ta mbajnë ritmin e bavarezëve, të cilët kryesojnë me 8 pikë para tyre. Mesfushori shqiptar në një intervistë të dhënë për portalin e Bundesligës ka pranuar se në futboll asgjë nuk është e garantuar. "Kundër Bayernit ndeshjet janë gjithmonë speciale. Ata kanë lojtarë të mëdhenj dhe janë një klub që e dinë se çfarë përfaqësojnë, por edhe ne nuk e dimë se jemi të fortë. Në fushën tonë e kemi treguar se shesim shtrenjtë lëkurën dhe të shtunën duam të bëjmë të njëjtën gjë edhe me Bayernin. Na duhet të jemi në maksimum për të arritur një fitore dhe jam i bindur se do ta mundim Bayernin", ka thënë Xhaka.

CAS-i e refuzon ankesën e Rumanisë për ndeshjen me Kosovën

Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (CAS) e ka refuzuar ankesën e Federatës Rumune të Futbollit. Kjo federatë kishte bërë ankesë në Lozanë për gjobën që e kishte marrë prej 128 mijë eurosh për veprimet e tifozëve në ndeshjen e ndërprerë në Bukuresht në nëntor të vitit të kaluar në mes të Rumanisë dhe Kosovës, të cilën më pas rumunët e fituan në tavolinë 3:0. Lajmi u dha edhe në faqen zyrtare të Federatës së Futbollit të Rumanisë. "Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ka refuzuar ankesën e Federatës Rumune të Futbollit kundër UEFA-s, duke konsideruar se sanksionet e vendosura ndaj FRF-së në lidhje me ndeshjen kundër Kosovës në Ligën e Kombeve nuk janë joproportionale". "Komisioni vendosi që shkeljet e rregullave nga tifozët rumunë ishin të rënda dhe se sanksionet e marra ishin në përputhje me Rregulloret Disiplinore të UEFA-s, jo disproporcionale". Në CAS ndaj vendimeve të UEFA-s ishte ankuar edhe Federata e Futbollit të Kosovës.

Kompletohet çerekfinalja e Kupës së Kosovës

PRISHTINË, 13 JANAR - Tashmë janë kompletuar të të skuadrat çerekfinaliste të Kupës së Kosovës. Sot u zhvilluan dy ndeshjet e fundit të 1/8 së finales. Fitoreve iu gëzuan Prishtina e Re dhe Ferizaj. Skuadra që garon në Ligën e Parë, Prishtina e Re arriti të triumfojë si mysafire përballë Feronikelit 74, me rezultat

2:0. Të dyja golat mysafirët i shënuan në pjesën e dytë. Fillimisht realizoi Kreshnik Bahtiri, në minutën e 68, derisa pesë minuta më vonë epërsinë e shtoi Fati Ismaili. Në ndeshjen tjetër Ferizaj shënoi fitore kundër Rilindjes 1974, me rezultat 1:0. Kështu, në çerekfinale janë kualifikuar: Drita, Prishtina, Vëllaznimi, Drenica,

Malisheva, Llapi, Prishtina e Re dhe Ferizaj. Rezultatet: Trepça-Drenica (0-0, 2-4 pas penalltive), Dinamo-Malisheva (0-2), Llapi-Vushtrria (2-0), Vëllaznimi-Gjilani (2-1), Drita-Dukagjini (0-0, 5-4 pas penalltive), Prishtina-Suhareka (4-0), Feronikeli 74-Prishtina e Re (0-2), Ferizaj-Rilindja 1974 (1-0).



Presidenti Ademi dhe ambasadori Rohde flasin për turneun e futbollit në muajin maj

PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka pritur sot në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde dhe ekipin e tij. Ademi ka shkruar në "Facebook" se ky takim shërbeu për t'i forcuar edhe më tej marrëdhëniet e FFK-së dhe për të diskutuar rreth

projektit të përbashkët në muajin maj. "Ambasadori është një fans i madh i futbollit dhe veçanërisht i Kombëtares së Kosovës, një fakt që na ka motivuar edhe më shumë për të avancuar në këtë drejtim. FFK dhe Ambasada e Gjermanisë në Kosovë do të realizojnë në muajin maj një turne

futbolli". "Në këtë takim, e falënderova Ambasadorin dhe ekipin e tij për mbështetjen e vazhdueshme që na kanë ofruar. Po ashtu, ai na përgëzoi për arritjet tona të fundit, veçanërisht për suksesin e madh të Kombëtares së Kosovës në arritjen e 'play-off' të Ligës së Kombeve. Ky është një

hap i jashtëzakonshëm për futbollin tonë dhe na motivon të synojmë edhe më shumë në të ardhmen. Jemi të lumtur që kemi partnerë të tillë që na mbështesin në çdo hap dhe mezi presim të shohim rezultatet e këtij bashkëpunimi", ka shkruar Ademi.



Ndërron jetë zyrtarja e FHK-së, Valbona Mehmeti

PRISHTINË, 13 SHKURT - Ka ndërruar jetë Valbona Mehmeti, zyrtarja financiare e Federatës së Hendbollit të Kosovës. E ndjera ishte pjesë e rëndësishme e administratës së FHK-së për dy dekada e gjysmë, përkatësisht që nga viti 2000 e tutje. Kontributi i saj për mbarëvajtjen e punëve në federatë, rrjedhimisht edhe në hendbollin e Kosovës, është i çmueshëm. E ka karakterizuar raporti i shkëlqyer me të gjithë, komunikimi shembullor me drejtues klubesh, punëtorë të hendbollit e hendbollistë dhe përkushtimi për të shërbyer për rritjen e vazhdueshme të imazhit të Federatës së Hendbollit të Kosovës dhe ruajtjen e aseteve të saj. Për shumë vjet e ndjera Valbonë është përbullur me një sëmundje të rëndë. Stafi tjetër i Federatës së Hendbollit të Kosovës i ka qëndruar vazhdimisht pranë deri në ditët e fundit të jetës. "Me pikëllim pritëm lajmin për ndarjen nga



jeta të koleges sonë të dashur, Valbona Mehmeti. Ajo ka shërbyer për Federatën tonë për periudhë të gjatë, ndërsa kontributi i saj është i tejet i çmuar në familjen kosovare të hendbollit. Në emër të komunitetit kosovar të hendbollit dhe sidomos të stafit

të FHK-së, i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së nderuar Mehmeti", shkruan në telegramin e ngushëllimit të presidentit të FHK-së, Edin Kolgeci. Të ndjerës të enjten pasdite i është dhënë lamtumira e fundit në varrezat e qytetit në Prishtinë.

Dominojnë Cavsi dhe Thunderi, fitojnë edhe Denveri dhe Dallasi

TORONTO, 13 SHKURT - Cleveland Cavaliersi e mbylli në krye këtë pjesë të sezonit në NBA, që do të ndërpritet për shkak të "All Star Game", pas fitores 131-108 në fushën e Toronto. Shtatë lojtarë të Cavaliersit realizuan mbi 10 pikë, duke e bërë kolektivitetin armën më të fortë. Në Perëndim, në krye të renditjes ndodhet Oklahoma, që mundi me shifrat 115-101 Miamin, ndeshje ku u dallua Alexander Shai me 32 pikë. Fitoi edhe skuadra kampione e Bostonit, që mundi 116-103 San Antonion, sfidë ku dyshja Tatum - Porzingis realizoi 61 pikë.



Zhënjehet skuadra e lakersave, që u mund me rezultat 131-119 nga Utah Jazz (Markkanen 32 pikë), ndërsa Clippersi, falë 25 pikëve të Leonardos, mundin me shifrat 128-114 Memphisin.

REZULTATET

Boston - San Antonio	116-103
Orlando - Charlotte	102-86
Washington - Indiana	130-134
Brooklyn - Philadelphia	100-96
New York - Atlanta	149-148
Toronto - Cleveland	108-131
Chicago - Detroit	110-128
Minnesota - Milwaukee	101-103
New Orleans - Sacramento	111-119
Oklahoma - Miami	115-101
Houston - Phoenix	119-111
Denver - Portland	132-121
Utah Jazz - Lakers	131-119
Dallas - Golden State	111-107
Clippers - Memphis	128-114

Kërcënuan se do të publikonin foto të Schumacherit të sëmurë rëndë, dënohen tre persona

Një gjykatë në Wuppertal të Gjermanisë ka dënuar tre shantazhues të familjes së ish-kampionit botëror të Formula 1, Michael Schumacher. I pandehuri kryesor, Yilmaz T, ka tentuar të zhvatë 15 milionë euro nga familja e shoferit duke

kërcënuar se do të publikojë foto dhe video në rrjetin e errët, në anën e fshehur të internetit. Djali i tij 30-vjeçar Daniel e ndihmoi atë të dërgonte informacionin nga një adresë emaili që është teknikisht e pagjurmueshme. Një burrë i tretë, i cili punoi si roje sigurie

për familjen e Michael Schumacherit deri në mars 2021, i shiti të pandehurit kryesor, midis tetorit 2022 dhe majit 2024, foto dhe video që tregonin Michael Schumacher para dhe pas aksidentit të tij në ski në vitin 2013, të cilin ai dyshohet se e kopjoi pa leje,

ndërsa ishte i punësuar nga familja e shoferit. I pandehuri kryesor Yilmaz u dënua me tre vjet burgim, djali i tij u dënua me një vit prove dhe 53-vjeçari i sigurimit u dënua me dy vjet shërbim prove. Që nga aksidenti që ndodhi në fund të vitit 2013 në resorin dimëror

francez të skive Meribel, Michael Schumacher nuk është parë në publik. Shtatë herë kampioni i Formulës 1 pësoi një lëndim të rëndë në kokë, kaloi gati gjashtë muaj në gjendje kome të shkaktuar dhe që atëherë po trajtohet në shtëpinë e tij në Zvicër.

SHKURT

Taulant Xhaka pensionohet në fund të sezonit

Mesfushori Taulant Xhaka do t'i japë fund karrierës si futbollist aktiv pas 13 sezoneve të luajtura, ku ka fituar 10 trofe dhe ka mbi 400 ndeshje të zhvilluara me fanellën e Baselit. Kështu ka njoftuar futbollisti 33-vjeçar për faqen zyrtare të Baselit të mërkurën. 33-vjeçari është rritur te Baseli, kurse për një periudhë ka luajtur edhe për Grasshopperin, si i huazuar. Gjithashtu, Xhaka ka luajtur për të gjitha gjeneratat e reja te Zvicra, ndërsa me Kombëtaren A të Shqipërisë ka regjistruar 31 paraqitje dhe ka shënuar një gol. Taulanti është vëllai i madh i Granit Xhakës.

Lara Colturi, e shtata në Austri mes 109 skiatoreve

Në pistën austriake të Saalbach po zhvillohet Kampionati Botëror i Skive, ku për Shqipërinë garoi të enjten skiatorja Lara Colturi. Ajo mori pjesë në garën e sllallomit gjigant, ku u rendit në vendin e shtatë. Një tjetër paraqitje e mirë e skiatoreve 18-vjeçare kuqezi, që u rendit mes garueseve më të mira. Në këtë garë morën pjesë 109 skiatore dhe Colturi u klasifikua e shtata me kohën e përgjithshme 2'26"21. Pas zbritjes së parë, Colturi u klasifikua në vendin e 9-të me kohën 1'12"92. Në zbritjen e dyta, koha e dhënë nga Colturi është 1'13"29. Pra, ajo arriti të fitonte dy pozicione pas zbritjes së dytë. Kjo paraqitje e mirë në Botëror, ku Colturi merr pjesë për herë të parë, pason ato rezultate të mira që skiatorja kuqezi ka dhënë këtë sezon në Kupën e Botës. Ajo do të garojë edhe në garën e sllallomit pas dy ditësh.

Owen: Zidane, lojtari më i mirë me të cilin kam luajtur

Michael Owen shpërfilli lojtarët si Steven Gerrard, Wayne Rooney dhe Paul Scholes kur emëroi "Lojtarin më të mirë" me të cilin luajti gjatë karrierës së tij të shkëlqyer. Owen, 45-vjeçar, pati nderin të ndante një fushë me disa futbollistë të talentuar gjatë karrierës së tij si lojtar me Liverpool, Real Madrid, Newcastle United, Manchester United, Stoke City dhe Kombëtaren e Anglisë. Ish-sulmuesi i lindur në Chester ishte një lojtar i klasit të lartë dhe shënoi 223 gola në 483 paraqitje në klub. Ai madje fitoi "Topin e Artë" në vitin 2001, duke mposhtur Raulin e Real Madridit në çmimin e lakmuar. "Zidane ishte lojtari më i mirë me të cilin kam luajtur ndonjëherë. Ai ka lindur absolutisht për të qenë një futbollist", ka thënë fillimisht Owen për "Off The Ball". Francezi luajti me Owen në 31 raste gjatë kohës së tyre te "Los Blancos". Owen e përshkroi shkathtësinë dhe forcën e ish-lojtarit të Juventusit si dy nga asetet e tij më të mëdha. "Ai ishte i jashtëzakonshëm. Këmba e majtë, këmba e djathtë, ai ishte kaq i shpejtë, aq i fortë. Ai mund të bënte një kthesë të Cruyff nga një vrimë e vogël dhe të shpërthejë", ka përfunduar Owen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Crest Cart” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811889700 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajje se svi klienti da drustvo sa “Crest Cart” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811889700 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Crest Cart” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811889700 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



143401&45 690 141

Adresa: rr.Ibrahim Krasniqi Prishtinë lurnshpk@gmail.com Nr tel: 045510011&46

Prishtinë, 13.02.2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810084062 me adresë: Rr. „Ibrahim Krasniqi“ nr. 10, Komuna e Prishtinës Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3861-2/23 dt. 23.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimi nr. 07-350/02-0032027/23 dt. 10.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimi për Kushte Ndërtimore Nr. 07-0350/04-0085583/23 dt. 12.02.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr. 07-351/02-0044941/24 të datës 29.11.2024 për “Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 483.12 kW, ZK Shajkoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 19358 dt.20.10.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratet për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut. Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: lurnshpk@gmail.com dhe LEGAL-LEECENSING@ero-ks.org Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Statkraft Markets GmbH Branch in Kosovo
Dukagjini Center
Xhevdet Doda Str. 21
Entry B/4, Suites B1, B2

10000 Pristina, Kosovo

NJOFTIM**Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të Energjisë Elektrike në Kosovë**

Ndërmarrja Statkraft Markets GmbH branch in Kosovo me adresë Dukagjini Center Xhevdet Doda Str. 21, Entry B/4, Suites B1, B2, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj NJOFTON palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë. Aplikacioni për licencim të këtij aktiviteti me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjësit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike i ndërmarrjes Statkraft Markets GmbH branch in Kosovo përveç tjerash do të përbëjë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit me çmime të parregulluara
- blejë dhe shes kapacitete dhe energji elektrike nga furnizuesit tjerë me çmime të parregulluara;
- shes kapacitete dhe energji elektrike furnizuesve tjerë me çmime të parregulluara; dhe
- transitojë, importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike.

I licencuari mund të kryej aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në pajtim me dispozitat e Licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. “Bekim Fehmiu”, (ish Ndërtesa e Fazitës), Kati II, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118.

Statkraft Markets GmbH branch in Kosovo

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Feim Thaqi nga Qifllaku i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; I, II, III, IV dhe diplomën Gjimnazit “Xhelal Hajda”, Rahovec, paralelet në Ratkoc.
- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Donjet Gashi, nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10, 11 të shkollës së mesme “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.
- Selmon Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik Identifikues të biznesit me nr. 810120684.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Mërgim Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh,m,t “Nexhmedin Nixha” A. Mekanik.
- Lëshohet banesa me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Rizo Hodaj nga Kabashi KK Prizren shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.a.t. “Abdyl Frashëri” Prishtinë Bukëpjekës.
- Dulë Gjuraj Gerqinë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.
- Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- “Aroni DF” SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin unik identifikues të biznesit 812228824 lëshuar nga ARBK.
- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

